




REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE PRANUAR/DORËZUAR: DATE: RECEIVED/SUBMITTED: 10. 2020			
Nr. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
01	47	1985	2



Republika e Kosovës

Republika Kosovo

Republic of Kosovo

Zyra Kombëtare e Auditimit

Nacionalna Kancelarija Revizije

National Audit Office

Prishtinë, 30 tetor 2020

Ref. 1985/01

Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike,  
Kuvendi i Republikës së Kosovës


**Lënda: Dorëzimi i Planit Vjetor të Auditimit për sezonin 2020/21**

I/ E nderuar,

Në përputhje me nenin 20.2 të Ligjit Nr. 205/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të republikës së Kosovës, ju dorëzojmë Planin Vjetor të Auditimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit për sezonin auditues 2020/21.

Me respekt,

Besnik Osmani

  
Auditor i Përgjithshëm

REPUBLICA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA			
ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT			
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE			
DATE PRANUAR/DORËZUAR: DATE: RECEIVED/SUBMITTED:			
Nr. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit  
Nacionalna Kancelarija Revizije  
National Audit Office

## Plani Vjetor i Auditimit

për sezonin e auditimit 2020/21  
(1 tetor 2020 deri më 31 gusht 2021)

Prishtinë, tetor 2020

## Tabela e përmbajtjes

1. Vizioni, Misioni dhe Vlerat .....	3
2. Hyrje .....	4
3. Llojet dhe Procesi i auditimit .....	5
4. Objektivat vjetore dhe Plani i auditimit .....	7
5. Buxheti dhe burimet njerëzore .....	11
6. Zbatimi .....	13

**Shtojca 1.** Subjektet dhe temat që do të auditohen

## 1. VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT

ZKA-ja është institucion i pavarur në shërbim të qeverisjes së mirë dhe publikut. ZKA-ja është e përkushtuar në përmbushjen e mandatit të saj kushtetues e ligjor, me një vizion të qartë strategjik.

### Vizioni

*“Institucion i besueshëm i auditimit,  
që përmirëson qeverisjen në sektorin publik,  
në interes të qytetarëve”*

### Misioni

*“Përmes auditimeve cilësore  
fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike  
për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik  
të burimeve kombëtare”*

### Vlerat e ZKA-së

*Pavarësia*

*Profesionalizmi*

*Integriteti*

*Transparenca*

## 2. HYRJE

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) si Institucion Suprem i Auditimit (ISA) kryen auditimin e jashtëm të sektorit publik në Republikën e Kosovës. Mandati dhe kompetencat e Auditorit të Përgjithshëm janë përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës (“Ligjin e ZKA-së”).

ZKA-ja auditon Pasqyrat Financiare Vjetore (PFV) të të gjitha organizatave buxhetore për të vlerësuar nëse ato ofrojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë dhe nëse paraja publike është shpenzuar për qëllimet për të cilat është aprovuar. ZKA-ja poashtu kryen auditime të performancës me synim të përmirësimit të shërbimeve për qytetarët dhe ofrimit të tyre me çmime të arsyeshme.

Ky dokument paraqet Planin Vjetor të Auditimit (PVA), i cili përfshinë të gjitha aktivitetet audituese për sezonin auditues 2020/21. Sipas Ligjit të ZKA-së, ky dokument dorëzohet tek Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike (KMFP), për çdo vit, deri më 31 tetor.

Në hartimin e këtij dokumenti janë marrë parasysh: Plani strategjik i ZKA-së (2018-2021), përmbushja e obligimeve kushtetuese e ligjore për auditime të rregullsisë, përzgjedhja e temave për auditime të performancës bazuar në vlerësimin mbi rëndësinë, nivelin e rrezikut dhe aktualitetin e tyre, përfshirja në auditim e një numri të ndërmarrjeve publike (bazuar në kapacitetet ekzistuese), adresimi i kërkesave specifike të palëve të interesit, etj. Planifikimi i këtyre auditimeve është bërë duke pasur parasysh edhe burimet njerëzore dhe financiare që ka në disponim ZKA-ja.

Jemi të vetdijshëm që sezoni i ardhshëm auditues do të jetë mjaft sfidues, pasi që do të realizohet në rrethana të shtrirjes së pandemisë në tërë vendin. Ndikimi i pandemisë ka qenë i dukshëm edhe gjatë sezonit të kaluar të auditimit, pasi që entitetet audituese kanë punuar me staf të reduktuar dhe në periudha të caktuara, sidomos kur auditorët e ZKA-së ishin në terren, shumë prej entiteteve ose ishin mbylluar ose punonin me staf esencial. Për më tepër disa prej auditorëve ishin prekur nga virusi Covid 19 dhe janë detyruar të izoloohen dhe t'i nënshtrohen trajtimit mjekësor. Kjo situatë e ka vështirësuar tej mase realizimin e Planit Vjetor të Auditimit 2019/20. Vlen të theksohet që përkundër këtyre sfidave dhe vonesave në përfundimin e auditimeve individuale, ZKA-ja ka arritur që të dorëzoj, brenda afatit ligjor, Raportin Vjetor të Auditimit të Buxhetit të Kosovës për vitin fiskal 2019.

Një sfidë tjetër e rëndësishme gjatë këtij sezoni do të jetë zbatimi paralel i **metodologjisë së re për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë** që është zhvilluar me përkrahjen e partnerit të projektit të binjakëzimit, Zyres Kombëtare të Auditimit të Polonisë, si dhe **sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit**. Të dy këto projekte shumë domethënëse për ZKA-në janë realizuar gjatë këtij viti pandemik, kur nga gjysma e muajit mars 2020 është punuar kryesisht duke përdorur komunikimin online. Me qëllim të futjes në përdorim të tyre, gjatë muajit shtator dhe në pjesën e parë të muajit tetor i tërë personeli i ZKA-së kanë ndjekur fillimisht trajnimin për zbatimin e metodologjisë së re audituese, e më pas edhe atë për përdorimin e sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit.

Si edhe deri më tani, auditimet do të realizohen në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA), duke u bazuar në vlerat univerzale të ISA-ve dhe të ZKA-së si, pavarësia, profesionalizmi, integriteti dhe transparencja. Të gjitha raportet e ZKA-së janë të qasshme për publikun dhe publikohen në faqen zyrtare të internetit.

### 3. LLOJET DHE PROCESI I AUDITIMEVE

#### 3.1. Llojet e auditimeve

Në përputhje me mandatin dhe fushëveprimin e vet, gjatë sezonit 2020/21, ZKA-ja do të kryej:

- **Auditime të rregullsisë** të organizatave buxhetore (bazuar në sistemin e parasë së gatshme) dhe të ndërmarrjeve publike (bazuar në sistemin aktual); dhe
- **Auditime të performancës**, përfshirë auditimet e teknologjisë së informacionit.

**Auditimet e rregullsisë:** përfshijnë auditimin e PFV-ve dhe llogarive kryesore të institucionit të audituar, me qëllim të vlerësimit nëse raportet janë të besueshme dhe llogaritë pasqyrojnë rezultatet e realizimit të buxhetit në mënyrë të drejtë; vlerësimin nëse menaxhmenti iu ka përmbajtur ligjeve dhe akteve nënligjore të zbatueshme dhe nëse fondet janë përdorur për qëllimet e synuara; vlerësimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar, funksionet e auditimit të brendshëm dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Sipas SNISA-ve të përditësuara nuk ekziston standard i veçantë për auditime të rregullsisë. SNISA-t i trajtojnë ndaras auditimet financiare nga ato të pajtueshmërisë, prandaj në vazhdim po japim definicionet për këto lloje të auditimeve.

- **Auditimi financiar.** Objektivi i auditimit të pasqyrave financiare është të rrisë nivelin e besimit tek përdoruesit e pasqyrave financiare. Kjo arrihet përmes dhënies së opinionit nga ana e auditorit nëse pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kornizën raportuese në fuqi; si dhe të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si tërësi nuk pëmbajnë keqdeklarime materiale, raste mashtrimi ose gabime, si dhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve të tij/saj.
- **Auditimi i pajtueshmërisë.** Objektivi i auditimit të pajtueshmërisë është që të informojë përdoruesit nëse entitetet publike të audituara respektojnë vendimet e Kuvendit, ligjet, aktet legjislative, politikat, kodet, praktikat e mira, etj.

Auditimet e rregullsisë kryhen për çdo vit. Procesi i auditimit fillon në shtator, ndërsa raportet e auditimit për OB-të individuale publikohen deri në fund të muajit qershor. Cikli i auditimeve përmbyllet në fund të muajit gusht kur Raporti Vjetor i Auditimit (RVA) për Raportin Financiar Vjetor të Buxhetit të Kosovës (RFV/BK) dorëzohet në Kuvendin e Kosovës.

**Auditimet e performancës:** paraqesin një shqyrtim të pavarur, objektiv dhe të besueshëm nëse angazhimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat janë duke vepruar në përputhje me parimet e ekonomicitetit (minimizimi i kostove të burimeve), efikasitetit (përfitimi sa më shumë nga burimet në dispozicion) dhe efektivitetit (përbushja e objektivave të përcaktuara dhe rezultateve të synuara). Fushat, objektivat dhe koha e auditimit dhe e raportimit përcaktohen prej rastit në rast, duke u bazuar në rëndësinë, rrezikun, fushëveprimin e auditimit, kapacitetet ekzistuese si dhe kriteret tjera përkatëse.

Auditimi i performancës fokusohet në atë se si organizatat e sektorit publik i kanë përdorur burimet në dispozicion për t'i arritur objektivat e tyre. Për ekzaminimin e performancës së entitetit të audituar, ZKA-ja ndjek një të një nga tri qasjet:

- qasjen e orientuar në *rezultate*, e cila vlerëson nëse janë arritur objektivat e paracaktuara;
- qasjen e orientuar në *problem*, e cila verifikon dhe analizon shkaqet e problemit(ve); ose
- qasjen e orientuar në *sistem*, e cila ekzaminon funksionimin e sistemeve menaxhuese: ose një kombinim të të tri qasjeve.

**Auditimet e teknologjisë së informacionit (TI).** Auditimi i TI-së definohet si ekzaminim dhe rishikim i sistemeve të teknologjisë së informacionit (TI) dhe kontrollet e ndërlidhura me to, për të përfutur siguri ose për të identifikuar rreziqet lidhur me parimet e ligjshmërisë, efikasitetit, ekonomicitetit dhe efektivitetit të sistemeve të TI-së dhe kontrolleve lidhur me këto sisteme. Në terma të përgjithshëm, auditimet e TI-së shtrihen në auditimet financiare, në auditimet e pajtueshmërisë, në auditimet e performancës, por mund të realizohen edhe si auditime të veçanta.

### 3.2 Procesi i auditimeve

**A. Procesi i auditimeve të rregullsisë** - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Rregullsisë (taks e tutje "Auditimeve Financiare dhe të Pajtueshmërisë") dhe SNISA-t. Auditimi i rregullsisë kryhet nëpër disa hapa duke filluar nga:

- njohja e entitetit dhe analiza e rreziqeve;
- planifikimi i auditimit;
- ekzekutimi i auditimit;
- dhënia e konkluzioneve dhe opinionit të auditimit;
- raportimi në Kuvend dhe informimi i opinionit publik (publikimi i raporteve); dhe
- përcjellja e adresimit të rekomandimeve të auditimit.

Procesi i auditimit të rregullsisë në ZKA monitorohet dhe rishikohet nga Departamenti për Metodologji dhe Sigurimin e Cilësisë, i cili ka përgjegjësinë të siguroj menaxhmentin që auditimet janë kryer duke u bazuar në metodologjinë e aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm dhe SNISA-t.

B. Procesi i auditimeve të performancës - bazohet në metodologjinë e auditimit të përshkruar në Doracakun e Auditimeve të Performancës dhe SNISA-t. Auditimi i performancës kryhet nëpër fazat në vijim:

**Grafiku 1: Fazat e procesit të auditimit të performancës**



**Faza 1. Planifikimi.** Përfshinë propozimin e temave për auditim dhe përgatitjen e memove parastudimore. Propozimet shqyrtohen përmes një procesi vlerësues lidhur me përshtatshmërinë dhe rëndësinë e temës për t'u audituar. Në këtë fazë poashtu, ekipet e auditimit bëjnë një hulumtim më të thellë rreth temës përkatëse, ku përcaktohen: problemi i auditimit, objektivat e auditimit, motivi i auditimit, fushëveprimi i auditimit, etj.

**Faza 2. Ekzekutimi i punës në terren.** Ekipet e auditimit pasi që të kenë përgatitur planin detaj të punës fillojnë me kryerjen e punëve audituese në terren dhe të hartojnë draft raportin e auditimit.

**Faza 3. Raportimi.** Ekipi auditues përfundon hartimin e raportit të auditimit, i cili duhet të jetë objektiv, gjithëpërfshirës, i qartë për lexuesin, etj. Pasi që raporti ka kaluar nëpër kontrollin e cilësisë dhe janë dhënë aprovimet e duhura, bën publikimin e tij.

**Faza 4. Përcjellja e auditimit.** Pasi të ketë kaluar një periudhë e përshtatshme kohe, ZKA-ja mund të kryejë një vlerësim të progresit të entitetit të audituar në përgjigjet ndaj gjetjeve të auditimit dhe zbatimit të rekomandimeve dhe të raportoje për to përmes një auditimi përcjellës. Bazuar në standardet e auditimit si dhe në Doracakun për auditime të performancës, auditimet përcjellëse jo domosdoshmërisht kryhen për secilin auditim të kryer paraprakisht. Lidhur me auditimet përcjellëse vendoset në bazë të rëndësisë së temës.

#### 4. OBJEKTIVAT VJETORE DHE PLANI I AUDITIMIT

Objektivat specifike të ZKA-së për sezonin auditues 2020/21 bazohen në Planin Strategjik të ZKA-së 2018-2021 me të cilin synohet përveç tjerash avancimi i metodologjisë së auditimit dhe përmirësimi i mëtejme i cilësisë së auditimeve. Për sezonën e auditimit 2020/21 janë planifikuar



124 auditime, siç janë paraqitur në Tabelën 1, në vijim. Plani auditues përfshin të gjitha auditimet e detyrueshme të rregullsisë të përcaktuara me nenin 18.3 të Ligjit të ZKA-së, gjithsejt 91; 13 projekte të financuara nga fondet e jashtme; 12 ndërmarrje publike dhe 8 auditime të performancës<sup>1</sup> - që për shkak të ndikimit të pandemisë është numër më i vogël krahasuar me sezonin e kaluar.

**Tabela 1: Numri dhe lloji i auditimeve të planifikuara për sezonin e auditimit 2020/2021**

Llojet e auditimit	Numri i auditimeve
<b>Auditime të rregullsisë (financiare dhe të pajtueshmërisë)</b>	<b>116</b>
- Buxheti i Kosovës	1
- Institucione të nivelit qendror	52
- Komuna	38
- Ndërmarrje publike	12
- Projekte të financuara nga fondet e jashtme	13
<b>Auditime të performancës<sup>2</sup></b>	<b>8</b>
- Auditime të performancës (prokurim & TI)	8
<b>Gjithsej</b>	<b>124</b>

Lista e të gjitha auditimeve është paraqitur në **Shtojcën 1** të këtij dokumenti.

Raportet individuale për auditimet e rregullsisë do të finalizohen deri më 30 Qershor 2021. Sipas afatit ligjor, Raporti Vjetor i Auditimit për Buxhetin e Kosovës pritet t'i dorëzohet Kuvendit të Kosovës jo më vonë se 31 gusht të vitit të ardhshëm<sup>3</sup>. Ndërsa, auditimet e performancës dhe të projekteve do të publikohen sipas kalendarit kohor të përcaktuar dhe aprovuar nga Auditori i Përgjithshëm.

Angazhimi i burimeve njerëzore është bërë duke marrë parasysh: disponueshmërinë me burime njerëzore si dhe kualifikimin dhe përvojën e stafit; madhësinë e buxhetit që auditohet, rrezikshmërinë dhe kompleksitetin e temës audituese; si dhe bazuar në përvojën nga vitet paraprake.

<sup>1</sup> Përveç auditimeve të reja që janë paraparë me këtë plan, në proces të finalizimit janë 5 auditime të performancës.

<sup>2</sup> Për temat e zgjedhura të auditimit të performancës, së pari do të kryhen parastudimet dhe pastaj do të vendoset për auditimin e tyre.

<sup>3</sup> Në respektimin e këtij afati mund të ndikoj situata pandemike!

#### 4.1 Fokusi i auditimeve të rregullsisë

Për dallim nga sezoni i kaluar, portofolio e auditimeve të rregullsisë është zvogëluar pasi me vendim të qeverisë numri i ministrive është zvogëluar nga 21 në 15. Poashtu numri i NP-ve<sup>4</sup> në auditim nga ZKA-ja ka rënë nga 14 në 12.

Për sezonin auditues 2020/21, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e rregullsisë (financiar dhe të pajtueshmërisë) së 13 projekteve të financuara nga donatorët. Prej të cilave, 11 projekte të financuara nga Banka Botërore dhe dy të financuara nga Agjencia Suedeze për Zhvillim (SIDA).

#### 4.2 Fokusi i auditimeve të performancës

Procesi i përzgjedhjes së temave të auditimeve të performancës këtë vit është ndikuar nga shtrirja e pandemisë Covid 19 në vendin tonë. Për këtë shkak, ZKA-ja nuk ka arritur të zhvillojë konsultimet e zakonshme me organizatat e shoqërisë civile dhe akterët e tjerë, megjithatë janë marrë parasysh propozimet, që janë konsideruar relevante, nga konsultimet e mëhershme. Në planin auditues 2020/2021 janë përfshirë tema nga fusha të rëndësishme, si: shëndetësia dhe siguria, ekonomia, investimet publike (prokurimi publik), mjedisi dhe teknologjia e informacionit. Për të përcaktuar planin vjetor të auditimeve të performancës, janë kërkuar propozime për temat nga të gjithë auditorët e ZKA-së. Pastaj temat e propozuara janë rishikuar nga udhëheqësit e departamenteve të auditimit dhe më pas janë diskutuar me Auditorin e Përgjithshëm dhe janë aprovuar nga ai.

Në vijim janë dhënë disa informata për fushat e përzgjedhura:

**Shëndetësia dhe siguria.** Marrë parasysh raportet e ZKA-së si dhe raportimet e vazhdueshme në media, sektori i shëndetësisë vazhdon të përballet me vështësi në ofrimin e kujdesit të duhur shëndetësor ndaj qytetarëve. Viteve të fundit, ZKA-ja ka kryer auditimin e “Sistemit Informativ Shëndetësor”, “Listën esenciale të barnave”, auditimin përcjellës “Menaxhimi i pajisjeve mjekësore” dhe është në proces të finalizimit të auditimit përcjellës “Programi i trajtimit të pacientëve jashtë Institucioneve Shëndetësore Publike”.

Fokusi për këtë fushë në sezonin vijues të auditimit do të jetë menaxhimi efektiv dhe efikas i situatave emergjente dhe menaxhimi i pandemisë Covid 19. Objektivë e auditimit *menaxhimi i situatave emergjente* do të jetë planifikimi dhe menaxhimi i situatave emergjente ku përfshihen procese të ndryshme duke filluar nga përgatitja, vlerësimi dhe zbatimi i politikave të nevojshme të planifikimit për menaxhimin me situata emergjente. Përderisa, auditimi i *menaxhimit të pandemisë Covid 19*, do të fokusohet në vlerësimin e zbatimit të masave të parapara me manualin për mbrojtje nga përhapja e virusit Covid-19.

---

<sup>4</sup> Në përzgjedhjen e NP-ve është marrë në konsideratë mbulueshmëria në tri nivele të organizimit (NP-të e nivelit qendror, rajonal dhe lokal), si dhe mbulueshmëria rajonale.

**Zhvillimi ekonomik dhe ruajtja e ambientit.** Viteve të fundit, ZKA-ja ka publikuar një numër të konsiderueshëm të auditimeve në fushën e zhvillimit ekonomik, duke trajtuar tema me interes si: subvencionet dhe grantet në zhvillimin e bujqësisë si një sektor i rëndësishëm në zhvillimin ekonomik, politikat e punësimit në sektorin publik, çmimet e tarifave të shërbimeve publike, kornizën afatmesme të shpenzimeve në sektorin e infrastrukturës dhe arsimit, investimet në komunitet e veriut përmes Fondit Zhvillimor dhe investimet në nivelin lokal përmes grantit të performancës komunale. Për shkak të rëndësisë që ka promovimi dhe mbështetja e investimeve të huaja për zhvillimin ekonomik, ZKA-ja ka iniciuar auditimin investimeve të huaja direkte, mirëpo ka pezulluar përkohësisht këtë temë për shkak të pandemisë e cila ka ndikuar në ngadalësimin e shumë proceseve të ndërlidhura me zhvillimin ekonomik në nivel global.

Për shkak të rëndësisë së madhe që ka **mjedisi**, ZKA-ja ka audituar tema të rëndësishme të kësaj fushe, siç janë “Cilësia e ajrit”, “Kontrolli dhe monitorimi i cilësisë së derivateve të naftës” dhe është në proces të finalizimit të raportit të auditimit lidhur me sistemin e licencimit të gurëthyesve dhe mbrojtjen e ambientit nga kjo veprimtari. Më herët ZKA-ja ka kryer poashtu auditimin për mbeturinat e amvisërisë dhe mbetjet medicinale, ndërsa për sezonin vijues të auditimit do të auditohet menaxhimi i mbeturinave komerciale, për shkak të ndikimit në jetën e qytetarëve dhe si një nga kushtet për anëtarësim në BE. Fokusi i auditimit do të jetë nëse institucionet përgjegjëse kanë krijuar parakushte për trajtimin adekuat të mbeturinave komerciale për të parandaluar apo evituar rrezikun nga këto mbeturina dhe substancat që përmbajnë ato.

**Prokurimi publik.** Në vitin 2019 përmes procedurave të prokurimit publik janë lidhur kontrata në vlerë prej 781 milion euro. Këto procedura janë zhvilluar nga 161 autoritete kontraktuese përgjegjëse për zhvillim të procedurave, ndërsa për 16 institucione të pavarura, procedurat e prokurimit janë zhvilluar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit. Auditimet e rregullsisë si dhe ato të performancës të kryera gjatë vitit 2019 kanë nxjerrë në pah një sërë mangësish në zhvillimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit në të gjitha fazat e prokurimit dhe në shumicën e autoriteteve kontraktuese. Viteve të fundit, ZKA-ja ka kryer auditimin e prokurimeve të centralizuara, procedurat me negociim pa publikim, tenderët në lloje, menaxhimin e kontratave të ndërtimit, Fondin Zhvillimor në komunitet në veri të Kosovës si dhe grantet e performancës komunale të financuara nga DEMOS. ZKA-ja është në proces të finalizimit të raportit të auditimit të prokurimeve të centralizuara (pjesa e dytë) si dhe të raportit të auditimit të kontratës së centralizuar për shërbimet e transportit ajror. Për sezonin auditues 2020/2021, ZKA-ja ka planifikuar auditimin e vlerës për para në ndërtimin e rrugëve lokale. Fokusi i këtij auditimi do të jetë ekonomia apo krahasimi i çmimeve për projekte/kontrata që kanë specifika të njëjta dhe të krahasueshme dhe do të përfshijë krahasimin e rrugëve të prokuruar nga qeveria qendrore me ato lokale. Po ashtu, do të auditojë, projektet e financuara nga grantet e performancës komunale përfshirë projektet e financuara nga DEMOS dhe nga Ministria e Pushtetit Lokal. Fokusi i këtij

auditimi do të jetë vlerësimi i pajtueshmërisë së procedurave të prokurimit si dhe arritja e qëllimeve për të cilat janë dhënë grantet.

**Teknologjia e Informacionit (TI).** Zhvillimi i vazhdueshëm i teknologjisë së informacionit dhe komunikimit ka bërë të mundur ruajtjen, procesimin dhe ofrimin e informacioneve në mënyrë elektronike. Me rritjen e aplikimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit është rritur edhe rëndësia dhe nevoja e auditimeve të TI-së. Në vitin 2020, ZKA-ja ka publikuar tri raporte të auditimit të TI-së “Menaxhimi i obligimeve tatimore në Sistemet e Informacionit të Administratës Tatimore të Kosovës”, “Qeverisja, menaxhimi i operacioneve dhe siguria e sistemeve të teknologjisë së informacionit në Agjencinë e Statistikave” dhe “Organizimi dhe menaxhimi i investimeve të teknologjisë së informacionit në institucionet publike”. Auditimet e kryera nga ZKA-ja kanë treguar se investimet e qeverisë në fushën e teknologjisë së informacionit janë bërë pa ndonjë analizë të mirëfilltë dhe si të tilla kanë rezultuar jo funksionale dhe duhet të bëhet edhe më shumë për të rritur besueshmërinë në këto sisteme.

Për sezonin auditues 2020/2021 janë planifikuar dy auditime në fushën e teknologjisë së informacionit “Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Gjykatat themelore dhe Këshillin Prokurorial të Kosovës” dhe “Sistemet e informacionit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve në bujqësi”. Objektivë e auditimit do të jetë vlerësimi i sigurisë dhe administrimit të sistemit informativ për menaxhimin e lëndëve<sup>5</sup>. Përderisa, objektivë e auditimit të sistemeve informative për grantet dhe subvencionet në bujqësi do të jetë vlerësimi nëse sistemet e informacionit për menaxhimin e granteve dhe subvencioneve e kanë arritur qëllimin për lehtësimin e menaxhimit dhe transparencës së aplikacioneve si dhe të sigurojnë integritetin, vlefshmërinë dhe besueshmërinë e të dhënave gjatë përpunimit të tyre.

Po ashtu, në sezonin vijues të auditimit për qëllime të auditimit të buxhetit të shtetit, do të bëhet auditimi i Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) nga personeli i auditorëve të TI-së të ZKA-së.

**Shoqëria civile.** Sipas Raportit të progresit për vitin 2019, mjedisi në të cilin vepron shoqëria civile vazhdoj të përmirësohej dhe autoritetet vazhdojnë të bëjnë përpjekje për të rritur aftësinë e shoqërisë civile për të kontribuar kuptimisht për zhvillimin e politikave. Sidoqoftë, përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar transparencën e fondeve publike për organizatat e shoqërisë civile. ZKA-ja në planin auditues 2020/2021 ka planifikuar auditimin e subvencionimit të Organizatave Jo-qeveritare (OJQ). Fokusi i këtij auditimi do të jetë vlerësimi i procesit të përzgjedhjes së OJQ-ve për subvencionim dhe si janë monitoruar për të siguruar se fondet e dhëna po shpenzohen për qëllimin që u janë ndarë.

---

<sup>5</sup> Duke marrë parasysh përmbajtjen e ndjeshme të informacionit të trajtuar nga Gjykatat dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës, është e qartë se një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet sigurisë së informacionit dhe mbrojtjes së të dhënave.

Viteve të fundit, ZKA-ja i kishte kushtuar një rëndësi të veçantë edhe fushës së Arsimit, duke audituar tema të rëndësishme si, procesi i rishikimit të teksteve shkollore, menaxhimi i teksteve shkollore si dhe efektiviteti i ndërlidhjes së arsimit dhe aftësisimit profesional me nevojat e tregut të punës. Ky i fundit ka nxjerrë në pah se sistemi aktual i arsimit dhe aftësisimit profesional nuk është në gjendje t'i përgjigjet nevojave dhe kërkesave të tregut të punës dhe se hartimi dhe rishikimi i kurrikulave të profileve të arsimit dhe aftësisimit profesional dhe harmonizimi i tyre me standardet e profesionit është përcjellë me vështirësi dhe ngecje të shumta. Për shkak të ndikimit të pandemisë Covid 19 dhe prioritetit që i është dhënë auditimit të kësaj çështjeje, për sezonin vijues të auditimit nuk kemi paraparë mbulimin e këtij sektori.

Vlen të theksohet se procesi i auditimit nuk përfundon me nxjerrjen e raportit të auditimit apo me përgatitjen e planit të veprimit për adresimin e rekomandimeve nga subjekti i audituar, pasi që veprimet e parapara nuk ofrojnë siguri që këto rekomandime do të zbatohen. Për këtë qëllim, është e nevojshme të bëhet monitorimi i zbatimit të rekomandimeve në baza të rregullta. Përcjellja e rekomandimeve të auditimit të performancës rrit efektivitetin e aktiviteteve të institucionit suprem të auditimit, përfshirë ndikimin e auditimit, si dhe rritjen e llogaridhënies ndaj publikut. ZKA-ja është në proces të vlerësimit të zbatimit të rekomandimeve të auditimit të performancës të dhëna në raportet e auditimit të publikuara në vitin 2017.

#### 4.3 Metodologjia e auditimit, kontrolli dhe sigurimi i cilësisë

Cilësia në auditim është kërkesë ligjore dhe e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit për Institucionet Supreme të Auditimit (SNISA). Puna e personelit të angazhuar në kuadër të Departamentit për Metodologji dhe Kontroll të Cilësisë së Auditimit fokusohet në aktivitete të caktuara për krijimin e kushteve për kryerjen e punëve audituese me cilësinë e duhur si dhe në zbatimin e mekanizmave të përcaktuar për kontrollin e cilësisë në gjithë procesin e auditimit.

Aktivitetet themelore gjatë këtij sezoni do të fokusohen në:

- hartimin dhe përditësimin e doracakëve të auditimit, letrave të punës, përcjelljen dhe prezantimin e ndyshimeve në SNISA, ofrimin e mbështetjes profesionale për auditorët, identifikimin e nevojave për trajnime dhe ofrimin e tyre. Këto aktivitete do të përkrahen nga Institucioni Suprem i Auditimit të Polonisë, cili zbaton projektin e binjakëzimit të financuar nga Bashkimi Evropian;
- përkujdesjen për zbatimin e metodologjisë së përditësuar përmes sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit;
- rishikimin e procesit të auditimit në të gjitha fazat dhe zbatimin e kontrollit të cilësisë në auditim sipas një plani të veçantë të punës; dhe
- analizimin e të dhënave të caktuara dhe përpunimin e tyre për qëllime të auditimit.

## 5. BUXHETI DHE BURIMET NJERËZORE

### 5.1. Buxheti

ZKA-ja financohet nga Buxheti i Republikës së Kosovës i cili miratohet nga Kuvendi i Kosovës, sipas procedurës së përcaktuar me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë.

Për vitin 2021, buxheti i miratuar i ZKA-së është rreth 2.8 milion €. Krahasuar me Ligjin Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, buxheti për vitin 2021 shënon një ulje prej 12% (përkatësisht 6% nëse krahasohet me Ligjin Nr. 07/L-014 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020). Kjo ulje është si rezultat i rishikimit të Kornizës Afatmesme të Shpenzimit dhe të ndryshimit të deklaratës së prioriteteve nga Qeveria e Kosovës. Poashtu, kjo shifër është më e ulët edhe për faktin se në vitin 2021, ZKA-ja nuk ka kërkesa të mëdha për projekte kapitale, pasi që projekti kapital i Sistemit Informativ të Auditimit „SITA“ është realizuar në vitin 2020 dhe pagesa e fundit e këtij projekti që do të kryhet në vitin 2021 ka të bëjë kryesisht me shpenzimet e mirëmbajtjes dhe të përditësimit të sistemit.

Sipas kategorive ekonomike, buxheti për paga dhe mëditje ka një rritje prej 0.5%, mallrat dhe shërbimet kanë ulje prej afërsisht 13% (përkatësisht 4% krahasuar me buxhetin e rishikuar), shpenzimet komunale janë rritur për mbi 11% (përkatësisht 43% krahasuar me buxhetin e rishikuar), derisa Investimet kapitale kanë ulje prej afërsisht 83% (përkatësisht 81% krahasuar me buxhetin e rishikuar).

Me ndarjen e miratuar buxhetore për vitin 2021, ZKA-ja nuk ka ndryshime në numrin e punonjësve. Kjo e vështirëson përmbushjen e objektivave institucionale për përfshirjen e të gjitha organizatave buxhetore në auditimin e rregullsisë, pastaj përfshirjen në auditimin e rregullsisë të më shumë ndërmarrjeve publike si dhe rritjen e numrit të auditimeve të performancës, sidomos në këto rrethana të situatës pandemike në vend. Në mungesë të burimeve të mjaftueshme, ZKA-ja është e detyruar për çdo vit të kontraktoj një kompani private të auditimit për të përkrahur auditimin e një numri të caktuar të organizatave buxhetore.

ZKA-ja ka marrëveshje bashkëpunimi me disa organizata homologe dhe partnerë ndërkombëtar. Aktivitetet e parapara në kuadër të këtij bashkëpunimi do të financohen kryesisht nga partnerët e ZKA-së.

### 5.2 Burimet njerëzore dhe trajnimet

Aktualisht ZKA-ja i ka të punësuar 171 punonjës, ndërsa i ka të miratuara me buxhetin vjetor 173 vende pune. Prej tyre 141 janë të angazhuar drejtpërdrejt në auditim, kurse pjesa tjetër në shërbimet tjera menaxheriale, profesionale, administrative dhe mbështetëse. Struktura kualifikuese e punonjësve auditues është e mirë dhe në proces të përmirësimit të vazhdueshëm.

Për të arritur qëllimet strategjike, ZKA-ja është duke investuar në zhvillimin e vazhdueshëm profesional të burimeve njerëzore. Punonjësve auditues do t'iu mundësohet vijimi i trajnimeve dhe arritja e normativit të përcaktuar me SNISA-t për arsimin e vazhdueshëm profesional, si një nga faktorët themelor për kryerjen e auditimeve me kompetencë, cilësi dhe sipas kërkesave të SNISA-ve.

Në ZKA, sipas planit vjetor të trajnimeve, mbahen trajnime të rregullta, kryesisht në muajt kur auditorët kanë më pak angazhime në procesin e auditimit. Trajnimet mbahen nga ekspertët e ZKA-së dhe ata të jashtëm, pastaj një numër i konsiderueshëm i punonjësve përfitojnë trajnime nga partnerët e jashtëm si, Zyra Kombëtare e Auditimit e Suedisë dhe ajo e Polonisë, Gjykata Evropiane e Auditorëve, Banka Botërore, USAID-i, etj.

Me organizimin e trajnimeve do të vazhdohet edhe për sezonin e auditimit 2020/21. ZKA-ja harton planin vjetor të trajnimeve që përfshinë trajnime nga personeli i ZKA-së dhe ekspertë të jashtëm. Përmbajtja e trajnimeve dhe mënyra e organizimit të tyre do të adaptohet në funksion të zbatimit të objektivave të përcaktuara strategjike dhe të menaxhimit të performancës individuale.

## 6. ZBATIMI

Plani do të zbatohet nga 21 tetori 2020 deri më 31 gusht 2021. Gjatë muajit shtator dhe tetor i tërë personeli i ZKA-së kanë ndjekur trajnimet për zbatimin e metodologjisë për auditime financiare dhe të pajtueshmërisë që është zhvilluar me përkrahjen e partnerit të projektit të binjakëzimit Zyrës Kombëtare të Auditimit të Polonisë, si dhe trajnimet për përdorimin e sistemit elektronik për menaxhimin e auditimit.

Për zbatimin e aktiviteteve të parapara me këtë dokument ZKA-ja do të përgatis plane të veçanta veprimi, sipas fushave dhe projekteve të caktuara.

Prishtinë, 20 tetor 2020

**Besnik Osmani**  
Auditor i Përgjithshëm



Shtojca 1. Subjektet dhe temat që do të auditohen

A. AUDITIMET E RREGULLSISË [FINANCIARE DHE TË PAJTUESHMËRISË]

Tabela 2: Institucione të nivelit qendror [1 + 52 = 53]

	Entitetet nën auditim	Buxheti 2020
1	Auditimi i Raportit Vjetor të Buxhetit të Republikës së Kosovës	2,620,368,600
2	Kuvendi i Kosovës	10,019,535
3	Zyra e Presidentit	3,380,122
4	Zyra e Kryeministrit	15,016,506
5	Ministria e Financave dhe Transfereve	345,208,528
6	Administrata Tatimore e Kosovës	13,172,685
7	Dogana e Kosovës	10,964,936
8	Ministria e Pushtetit Lokal	4,927,121
9	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural	57,627,856
10	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	7,052,000
11	Ministria e Infrastrukturës	130,704,711
12	Ministria e Shëndetësisë	51,076,501
13	Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës	117,086,365
14	Fondi i Sigurimeve Shëndetësore	9,379,692
15	Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	38,546,389
16	Ministria e Arsimit dhe Shkencës	63,016,677
17	Universiteti i Prishtinës	31,041,403
18	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	481,075,414
19	Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit	4,762,114
20	Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	155,343,402
21	Ministria e Punëve të Brendshme	148,722,254
22	Ministria e Drejtësisë	30,106,574
23	Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	28,928,646
24	Ministria e Mbrojtjes	63,602,303
25	Ministria e Zhvillimit Rajonal	4,521,825
26	Këshilli Prokurorial i Kosovës	13,727,289
27	Komisioni i Pavarur i Minierave dhe Mineraleve	1,256,783
28	Këshilli Gjygjësor i Kosovës	28,375,451
29	Fondet në Mirëbesim	9,379,693
30	Agjencioni Kosovar i Privatizimit	7,159,680
31	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik	771,446
32	Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës	1,160,941
33	Autoriteti i Rregullator i Komunikimeve Elektronike dhe Postare	865,385



34	Agjencia Kundër-Korrupsion	548,311
35	Zyra Rregullatorit për Energji	756,363
36	Organi Shqyrtues i Prokurimit	363,538
37	Agjencia për Ndihmë Juridike Falas	379,588
38	Gjykata Kushtetuese e Kosovës	1,768,622
39	Autoriteti Kosovar i Konkurrencës	340,051
40	Këshilli i Kosovës për Trashigimi Kulturore	204,260
41	Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa	194,239
42	Këshilli i Pavarur Mbikqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës	362,561
43	Autoriteti Rregullativ i Shërbimeve të Ujit	360,402
44	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave	375,169
45	Autoriteti i Aviacionit Civil	923,706
46	Komisioni i Pavarur i Mediave	842,322
47	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	6,556,481
48	Institucioni i Avokatit të Popullit	1,237,937
49	Akademia e Drejtesisë	727,895
50	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	2,413,248
51	Agjencia për Informim dhe Privatësi	353,292
52	Agjencioni për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale	3,272,329
53	Agjencioni për Shërbimet e Navigimit Ajror	7,248,889

**Tabela 3: Komuna [38]**

	<b>Entitetet nën auditim</b>	<b>Buxheti 2020</b>
1	Prishtinë	91,738,141
2	Obiliq	11,437,447
3	Podujevë	24,165,070
4	Fushë Kosovë	12,621,667
5	Mitrovicë	22,152,938
6	Graçanicë	8,101,328
7	Mitrovica e Veriut	6,450,651
8	Zubin Potok	2,564,767
9	Zveçan	2,460,695
10	Prizren	51,020,486
11	Mamusha	1,981,804
12	Malishevë	15,583,802
13	Rahovec	14,762,420
14	Lipjan	18,045,793
15	Shtime	7,937,712
16	Suharekë	16,987,460
17	Shtërpcë	4,221,098
18	Klllokot	1,137,495
19	Gjilan	27,614,397

20	Viti	12,318,790
21	Novobërdë	3,075,633
22	Ferizaj	33,516,833
23	Klinë	11,054,140
24	Pejë	28,855,746
25	Istog	11,610,676
26	Glllogoc	16,530,458
27	Skenderaj	15,029,829
28	Vushtrri	20,038,259
29	Gjakovë	27,332,147
30	Deçan	9,758,096
31	Kamenicë	9,401,944
32	Partesh	1,216,548
33	Ranillug	1,918,848
34	Kaçanik	9,013,830
35	Hani i Elezit	2,787,095
36	Dragash	9,161,759
37	Junik	1,631,096
38	Leposaviq	4,827,705

**Tabela 4: Ndërmarrje publike [12]**

	<b>Entitetet nën auditim</b>	
1	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë	
2	Hekurudhat e Kosovës - TrainKos	
3	Hortikultura	
4	KRU Hidromorava	
5	KRU Hidroregjioni Jugor	
6	KRU Prishtina	
7	KR e Ujitjes Drini i Bardhë	
8	KRM Pastrimi - Prishtinë	
9	Telekomi i Kosovës	
10	Posta e Kosovës	
11	KRU Bifurkacioni sh.a Ferizaj	
12	Ndërmarrja e Re Energjetike e Kosovës	

**Tabela 5: Projekte që financohen nga huamarrja shtetërore dhe nga donatorët [13]**

	<b>Entitetet nën auditim</b>	<b>Buxheti</b>
1	Projekti për përmirësimin e sistemit edukativ në Kosovë (MASHT - BB)	3.134.454
2	Konkurrueshmëria dhe gatishmëria për eksport (MTI - BB)	1.069.643
3	Efiçienca e Energjisë së ripërtitshme (MZHE - BB)	7.473.736
4	Zhvillimi Rural dhe Agrobujqësor (MBPZHR - BB)	7.070.633
5	Ekonomia Digjitale në Kosovë (MEA – BB)	6.146.373
6	Projekti për Shëndetësinë e Kosovës (MSH - BB)	5.257.932
7	Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MSH - BB)	8.000.000
8	Financimi i emergjencës pandemike në Kosovë (MSH - BB)	1.768.130
9	Projekti i emergjencës Covid-19 në Kosovë (MPMS - BB)	28.780.000
10	Pasuria e paluajtshme & infrastruktura gjeohapësinore (Agjencia Kadastrale e Kosovës - BB)	300.000
11	Projekti “Komunat për rininë në Kosovë” (MPL – BB))	300.000
12	Përkrahja për përmirësimin e hartimit/zhvillimit të politikave në Kosovë (ZKM - SIDA)	276.300
13	Programi Mjedisor i Kosovës – PMK 2016-2020 (MMPH - SIDA)	629.526

## **B. AUDITIMET E PERFORMANCËS**

**Tabela 6: Temat e auditimeve të performancës [8]**

	<b>Temat nën auditim</b>	
1	SMIL- Sistemi për Menaxhimin Informativ të Lëndëve në Gjykata dhe Prokurori	
2	Sistemet Elektronike për Menaxhimin e Granteve dhe Subvencioneve në AZHB-MBPZHR	
3	Auditimi i fondeve të DEMOS-it dhe MPL-së - grantet e performancës komunale	
4	Vlera për para për ndërtimin e rrugëve lokale	
5	Menaxhimi i pandemisë Covid 19	
6	Subvencionimi i OJQ-ve në arritjen e qëllimeve të synuara	
7	Menaxhimi i mbeturinave komerciale	
8	Menaxhimi i situatave emergjente	



**Zyra Kombëtare e Auditimit**  
**Nacionalna Kancelarija Revizije**  
**National Audit Office**

<http://www.zka-hks.org>